

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë

Varshavë, Poloni

Nga data 23 deri 26 shtator 2013

Rezolutë mbi transparencën e praktikave në fushën e të dhënave personale

Në gjurmët e Rezolutës, që synon përmirësimin e praktikave të informacionit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë, të miratuar gjatë Konferencës së 25-të ndërkombëtare të komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë, në 2003-shin;

Të ndërgjegjshëm që shkalla dhe fushëveprimi i mbledhjes së të dhënave personale, kapaciteti i analizimit dhe përdorimeve potenciale të këtyre të dhënave, janë rritur në masë të konsiderueshme;

Duke nënvizuar se transparenca përbën një parim bazë, prej kohe të gjatë, në fushën e përpunimit të informacionit, me të cilin merren shumë instrumente ndërkombëtarë, veçanërisht “Standardet Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e Privatësisë dhe të Dhënave Personale” – Deklarata e Madridit, të cilat u miratuan gjatë Konferencës së 31-të ndërkombëtare të komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë, në 2009-ën;

Duke pohuar se transparenca në lidhje me politikat dhe praktikat e qeverive, në fushën e informacioneve personale, është përcaktuese për krijimin dhe ruajtjen e besimit, favorizimin e angazhimit të qytetarëve dhe për të garantuar detyrimin e llogari-dhënies brenda një demokracie;

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë, **duhet** të bëjnë si më poshtë vijon:

1. Të nxisin organizatat që mbledhin të dhëna personale që të shpjegojnë qëllimet për të cilat ato mblidhen, për të treguar emrin dhe koordinatat e organizatës apo të personit përgjegjës dhe të përcaktojnë rrugën që duhet ndjekur për të kërkuar akses në këto informacione apo për t'i korrigjuar;
2. Të nxisin organizatat që të japin informacione të nevojshme mbi politikat e tyre dhe praktikat në fushën e mbledhjes së të dhënave, me gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, në një format lehtësisht të aksesueshëm dhe duke llogaritur karakteristikat e individëve, informacionet e të cilëve po merren dhe mbi mënyrën e mbledhjes;
3. Të nxisin organizatat, autoritetet e ngarkuara me mbrojtjen e të dhënave dhe me zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së privatësisë, në mënyrë që qeveritë të detyrohen t'u drejtohen vulave të akreditimit, certifikimit dhe markave të besimit, në fushën e mbrojtjes

së privatësisë, për të informuar përdoruesit dhe për t'i ndihmuar të bëjnë zgjedhje më të qarta;

4. Të nxisin qeveritë të bëjnë transparencë më të madhe, në atë që ka të bëjë me praktikën e mbledhjes së të dhënave, gjithë duke mbajtur parasysh konsideratat e rëndësishme në lidhje me sigurinë kombëtare, sigurinë publike dhe politikën publike, me qëllim përforcimin e detyrimit për llogari-dhënie brenda një demokracie dhe garantimin e ushtrimit të plotë të së drejtës themelore për privatësi.

Shënim shpjegues

Në shkallë ndërkombëtare, parimi i transparencës rrjedh nga *Udhëzimet që rregullojnë mbrojtjen e privatësisë dhe qarkullimet ndërkufitare të së dhënave me karakter personal* të OCDE-së, të cilat janë hartuar nga fundi i viteve 70. Sot, ky parim figuron përgjithësisht në ligjet mbi mbrojtjen e informacioneve personale dhe privatësisë, në fuqi kudo në botë.

Individët presin sot përgjegjshmëri dhe transparencë të lartë nga ana e organizatave të sektorit privat dhe të qeverive të tyre, në lidhje me mënyrën me të cilat ato mbledhin, përdorin dhe komunikojnë të dhënat personale, por këto pritshmëri jo gjithnjë përmbushen.

Në vitin 2013, nëntëmbëdhjetë autoritete nga e gjithë bota, morën pjesë në një inspektim ndërkombëtar të internetit, për herë të parë, organizuar nga Rrjeti Global i Zbatimit të Privatësisë (GPEN). Ato ekzaminuan faqe në internet, në kuadër të një iniciative të bashkërenduar, që synonte të vlerësonte transparencën e praktikave të mbrojtjes së privatësisë që zbatohen nga organizatat.

Autoritetet konstatuan se, në një rast ndër pesë, politika e konfidencialitetit nuk ekzistonte ose ishte e vështirë për t'u gjetur, e mbuluar siç ishte nga një tekst i tërë juridik ose në dokumentin që paraqiste modalitetet e përdorimit të faqes së internetit. Në faqet ku ajo ishte publikuar, politika e konfidencialitetit kufizohej shpesh në riparaqitjen e formulimit të detyrimeve ligjore, pa u dhënë përdoruesve informacione të qarta dhe të nevojshme mbi përdorimin dhe komunikimin e të dhënave të tyre personale. Autoritetet që morrin pjesë në këtë inspektim, vërejtën gjithashtu, në një numër të madh rastesh, se faqet e internetit nuk shfaqnin të dhënat e informacioneve të kontaktit, në mënyrë që t'u bënin të mundur individëve të marrin informacione shitesë mbi praktikën e organizatës, apo ishte e vështirë të gjeje këto të dhëna.

Zbulimet e fundit, në lidhje me programet qeveritare tëurvejimit, kanë ngjallur gjithashtu reagime në favor të një transparence më të madhe, për sa i përket zbatimit të këtyre programeve, të një përforcimi të mbikëqyrjes dhe të detyrimit për të dhënë llogari mbi këto programe, ashtu si edhe për një transparencë të madhe nga ana e organizatave të sektorit privat, të cilat janë të detyruara t'u komunikojnë qeverive të dhëna personale. Këto zbulime kanë ngjallur debatin mbi

nivelet e transparencës së përshtatshme në lidhje me këto programe, nën ndikimin e konsideratave të rëndësishme të sigurisë kombëtare, publike dhe politikës publike.

Komisioni Federal i Tregtisë (Shtetet e Bashkuara) abstenoj në votimin e kësaj rezolute, sepse ajo përfshin sektorin publik, i cili nuk është kompetencë e tij.